



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 154 Prot.

Tiranë, më 7.05.2019
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTUAR: AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë" Urdhërin e Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë", dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për 1 (një) vende të lirë pune në pozicionin e **Specialistit pranë Sektorit të Shërbimeve dhe Publikimit.**
Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, me formim në një nga fushat, Informatikë/Elektronikë, Gazetari/Komunikim, Shkenca Shoqërore, Shkenca Humane.
2. Preferohen kandidatë të cilët kanë përvojë pune në profesion që ka lidhje me pozicionin e shpallur, si dhe kandidatët që kanë përvojë pune në arsim ose që kanë lidhje me arsimin e lartë.
3. Të zotërojë gjuhën angleze, me dëshmi në nivel të avancuar.
4. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë dhe të avancuara, sistemeve të menaxhimit si dhe të njohë programet dhe metodat e publikimit të dhënave.
2. Preferohen candidate që kanë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë dhe njohuri mbi institucionet, programet e studimit, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të sistemit të akreditimit.
3. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese.
4. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmime të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj të shkruar dhe folur, dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 31.05.2019, ora 16:00 në adresën e mëposhtme:

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjinnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

- *Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;
www.ascal.al*

DREJTORI


Elvin Gjevori

